



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 4  
06.12.2010

NR. VENDIMI 14  
14.12.2011

**VENDIM**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë prej gjyqtarëve:

<b>Liljana BAKU</b>	<b>K/ trupit gjykues</b>
<b>Iliriana OLLDASHI</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Bardhyl DHAMA</b>	<b>Anëtar</b>

Asistuar nga sekretare seance **Andina KAJA**, sot në datë 14.12.2011, përfundoi në seancë gjyqësore publike, gjykimin e kërkesës Nr. 4/18 Rregjistri që i përket palëve:

**KËRKUESE:**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Xxxxx, përfaqësuar nga prokuror **A. XH. .**

**KUNDËR**

**SHTETASVE NËN HETIM**

**1. A. Sh. ,** i biri i A. dhe i R. , i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në xxxxxxxxxxx-xxxx dhe banues në Rrugën ”xxxx xxxxxx”, xxxxx, me zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar, sipas Prokurës së Posaçme Nr. 338 Prot. datë 07.02.2011, nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh. D. me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë Xxxxx.

**2. S. Sh. ,** i biri i A. dhe i R. , i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në

xxxxxxx-xxxx dhe banues në Rugën.”xxxx xxxxxx”, xxxxx, përfaqësuar, sipas Prokurës së Posaçme Nr. 338 Prot. datë 07.02.2011, nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh. D. me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tirane.

### **PERSONAVE TË TRETË:**

**1. C. M.** , i biri i A. dhe i T. , i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në fshatin xxxxx-xxxx dhe banues në Rugën ”xxxx xxxx”, ish Fusha e Aviacionit, Pallati Nr.xx, Xxxxx, me zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh. D. , me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë Xxxxx, zgjedhur me deklaram në seancë.

**2. F. Z.**, i biri i Sh. dhe i H., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në xxxxxxxx-xxxx, me zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh. D. me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë Xxxxx, zgjedhur me deklaram në seancë.

**3. N. M.** i biri i A. dhe i T. , i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në fshatin xxxxx-xxxx dhe banues në Xxxxxx xxxxx, me zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar, sipas Prokurës së Posaçme Nr. xxx Rep. Nr. xxx Kol. datë xx.xx.xxxx, nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh. D. , me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë Xxxxx.

**4. N. O.** e bija e S. dhe e Z. , e datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur ne xxxx xxxx dhe banuese në Xxxxxx xxxxx, me zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar, sipas Prokurës së Posaçme Nr. xxx Rep. Nr. xxx Kol. datë xx.xx.xxxx, nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh. D. me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë Xxxxx.

**5. A. H.** i biri i S. dhe i F. , i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në xxxx xxxxxx dhe banues në Xxxxxx xxxxx, me

zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar, sipas Prokurës së Posaçme Nr. xxxx Rep. Nr. xxx Kol. datë xx.xx.xxxx, nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh. D., me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë Xxxxx.

**6. S. M.** i biri i A. dhe T. , i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në fshatin xxxxx xxxxxx dhe banues në Lagjen “xx Xxxxxi” Xxxxxx xxxxx, me zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar, sipas Prokurës së Posaçme Nr. xxxx Rep. Nr. xxx Kol. datë xx.xx.xxxx, nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh. D. , me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë Xxxxx.

**7. Z. Z.** i biri i Sh. dhe i H., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në fshatin xxxxxxx-xxxx, me zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar, sipas Prokurës së Posaçme Nr. xxxx Rep. Nr. xxxx Kol. datë xx.xx.xxxx, nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh. D., me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë Xxxxx,

**8. S. G.** i biri i A. , i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në xxxx i xxxx xxxxx dhe banues në xxxxx, me zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar, sipas Prokurës së Posaçme Nr. xxxx Rep. Nr. xxxx Kol. datë xx.xx.xxxx, nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh. D., me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë Xxxxx.

## **OBJEKTI:**

### **Konfiskimi i pasurive:**

**1.** Llogarisë në xxxx në Bankën Intesa San Paolo, Dega Xxxxx, me Nr. xx xx xx xx xxx, e hapur në datë xx.xx.xxxx, në emër të A. Sh. ku gjendja aktuale (në momentin e verifikimit datë xx/xx/xxxx) është x,xxx xxxx (xxxxx e xxxxxxxx e xxxxxxxxxxxx e xxxxxx) xxxx.

**2.** Llogarisë në USD amerikane në Bankën Intesa San Paolo, Dega Xxxxx, me Nr. xx xx xx xx xx xx, e hapur në datë xx.xx.xxxx, në emër

të A. Sh. , me depozitim fillestar xxx (xxxxxxx e xxxxxxxxxxx) xxx, dhe gjendje aktuale (në momentin e verifikimit datë xx/xx/xxxx) xxx (xxxxxxx e xxxxxxxxxxx e xxxxx) xxxxx amerikanë.

**3.** Llogarisë në Bankën Intesa San Paolo, Dega Xxxxx, me Nr.xx xx xx xx xx xx, e çelur në datë xx.xx.xxxx, në emër të A. Sh. , gjendja aktuale e kësaj llogarie (në momentin e verifikimit datë xx/xx/xxxx), është xxx.xxx (xxxxxxx e xxxxxxxxxxx e xxxxx e xxxxxxxxxxx e xxx) xxxx.

**4.** Llogarisë në Banken Intesa San Paolo, Dega Tirane me Nr. xx xx xx xx xxx, e çelur në datë xx.xx.xxxx, në emër të A. Sh. , me gjendje të saj në momentin e verifikimit, datë xx/xx/xxxx, xxx.xxx (xxxxxx e xxxxx e xxxxxxxx e xxxxxxxxxxx e xxxxxxxxxxx e xxx) xxxx dhe, gjendje aktuale xxx.xxx.xx (xxxxxx e xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx e xxxxx e xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx e xxxxx pikë xxxxxxxxxxx e xxxxx) xxxx.

**5.** Llogarisë bankare, të celur pranë Bankës Intesa San Paolo, Dega Fier në emër te A. Sh. , me numur bazë të klientit xx xx xx dhe numur depozite me afat xxx xx xx xx xx xx xxx, me gjendje në momentin e verifikimit, datë xx/xx/xxxx, xxx,xxx (xxxxxx e xxxxxxxx e xxxxxxx) xxxx dhe gjendje aktuale xxx.xxx.xx (xxxxxxx e xxxxxxxxxxxx e xxxxxxxx e xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx e xxxxx pikë xxxxxxxxxxx e xxxxx) xxxx.

**6.** Llogarisë bankare në xxxx, me Nr.xx xx xx xx xxx , çelur në datë xx.xx.xxxx, në emër të S. Sh. dhe F. Z. , në Bankën Intesa San Paolo, Dega xxxxx, në shumën prej 500.000 (pesëqindmijë) euro, me gjendje në momentin e verifikimit, datë xx/xx/xxxx, xxx,xxx (xxxxxxx e xxxxxxxx e xxxxx e xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx e xxx) xxxx.

**7.** Llogarisë bankare në xxxx në Banken Intesa San Paolo, Dega Tirane, me Nr. Xx xx xx xx xxx, e çelur në datë xx.xx.xxxx, në emër të C.

M. , me një transaksion të vetëm po në këtë datë, në shumën 500.000 (pesëqindmijë) euro.

**II.** Për administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive të ngarkohet Z. R. H. , i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë ndërsa, për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohen zyrat e përmbarimit të rretheve ku ndodhen këto pasuri.

**BAZA LIGJORE:**

Ligji Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në përfundim të gjykimit, në kushtet e qënies së saj kompetente për të gjykuar dhe vendosur në bazë të nenit 7 pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi shqyrtoi provat e paraqitura dhe të marra në gjykim, dëgjoji pretendimet përfundimtare të palëve në të cilat u kërkua:

**Prokurori A. Xh. :** Pranimin e kërkesës duke u konfiskuar:

Llogaria në leke, në Bankën Intesa San Paolo, Dega Tirane, me Nr. xx xx xx xx xxx e hapur në datë 11.08.2005, në emër të shtetasit A. Sh. ku gjendja aktuale (në momentin e verifikimit datë 21/05/2009) është 2,966 lekë (dymijë e nëntëqind e gjashtëdhjete e gjashtë) lekë.

Llogaria në USD amerikane, në Bankën Intesa San Paolo, Dega Tirane, me Nr. xx xx xx xx xx xx, e çelur në datë 17.05.2006, në emër të shtetasit A. Sh. , me depozitim fillestar 960 (nëntëqind e gjashtëdhjetë) USD dhe, gjendje aktuale (në momentin e verifikimit datë 21/05/2009) 967 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) dollarë amerikanë.

Llogaria në Bankën Intesa San Paolo, Dega Xxxxx, me Nr.xx xx xx xx xx xx, e çelur në datë 08.11.2005, në emër të shtetasit A. Sh. , gjendja aktuale e kësaj llogarie (në momentin e verifikimit datë 21/05/2009), është 507.271 (pesëqindë e shtatëmijë e dyqind e shtatëdhjete e një) euro.

Llogaria në Bankën Intesa San Paolo, Dega Xxxxx, me Nr. xx xx xx xx xxx, e çelur në datë 03.01.2008, në emër të shtetasit A. Sh. , gjendja e kësaj llogarie (në momentin e verifikimit datë 21/05/2009), është 525.671 (pesëqind e njëzet e pesëmijë e gjashtëqindë e shtatëdhjetë e një) euro kurse, aktualisht është 519.274.85 (pesëqindë e nëntëmbëdhjetëmijë e dyqind e shtatëdhjete e katër pikë tetëdhjetë e pesë) euro.

Llogaria bankare, e çelur pranë Bankës Intesa San Paolo, Dega Fier, në emër të shtetasit A. Sh. , me numur bazë të klientit xx xx xx dhe numur depozite me afat Nr.xxx xx xx xx xx xxx, gjendja (në momentin e verifikimit datë 21/05/2009) ka qënë 533,000 (pesëqindë e tridhjetë e tremijë) euro kurse, aktualisht është 549.965.38 (peseqindë e dyzetë e nëntëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë, pikë tridhjetë e tetë) euro.

Llogaria bankare në xxxx, me Nr.xx xx xx xx xxx, çelur më datë 09.01.2008 në emër të shtetasve S. Sh. dhe F. Z. , në Bankën Xxxxxx xxx xxxxx, Dega Xxxxx, në shumën prej 500.000 (pesëqindmijë) euro. Gjendja aktuale (në momentin e verifikimit datë 21/05/2009) ka qënë 522,561 (pesëqind e njezetë e dymijë e pesëqindë e gjashtëdhjetë e një) euro.

Llogaria bankare në xxxx në Bankën Intesa San Paolo, Dega, Tiranë, me Nr. xx xx xx xx xxx, e çelur në datë 20.05.2009, në emër të C. M. me një transaksion të vetëm, po në këtë datë, në shumën 500.000 (pesëqindmijë) euro.

Për Administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive të ngarkohet Z.A. H. , i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë ndërsa, për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohen zyrtarë e përmbarimit të rretheve ku ndodhen këto pasuri.

Shpenzimet procedurale të kryera deri më tani në shumën 952.776 (nëntëqind e pesëdhjetë e dymijë e shtatëqindë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë si dhe, shpenzimet gjyqësore të ngarkohen personave të hetuar si dhe personave të tretë.

**Përfaqësuesi i Posaçëm i shtetasve nën hetim dhe personave të tretë, Av. Sh. D. :** Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria pranë kësaj Gjykate duke urdhëruar heqjen e masës së sekuestros vendosur mbi pasurinë objekt konfiskimi.

## V Ë R E N

Shtetasit nën hetim A. Sh. dhe S. Sh. janë banorë të fshatit Drenovicë Berat dhe vëllezër midis tyre. Personi i tretë C. M. është kunati i shtetasve nën hetim (bashkëshorti i motrës) dhe banor i Tiranës. Personi tjetër i tretë F. Z. është banor i fshatit Drenovicë, bashkëfshatar dhe lidhje shoqërore e shtetasve nën hetim, vëllezërve Sh. .

Në datë 06.12.2010 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane ka paraqitur para kësaj Gjykate, kundër shtetasve nën hetim Aleksandër dhe S. Sh. dhe personave të tretë C. M. dhe F. Z. , kërkesën me objekt konfiskimin e pasurisë së përshkruar hollësisht në

pjesën hyrëse të vendimit.

Nga aktet bashkëngjitur kërkesës dhe, paraqitur e shqyrtuar në seancë gjyqësore ka rezultuar se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, në datë 26.04.2010, ka rregjistruar procedimin pasuror në ngarkim të shtetasve Al. Sh. dhe S. Sh., si të dyshuar për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Ky procedim është rrjedhojë e procedimit penal Nr. 1927 viti 2009, të rregjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

Nga përmbajtja e materialit hetimor, që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane ka përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, ka rezultuar se, procedimi pranë saj ka filluar mbi bazën e informacioneve të marra nga ana e autoriteteve gjyqësore greke. Autoritetet greke kanë informuar se shtetasi A. Sh. dhe vëllai i tij, S. Sh. , që nga viti 2008 po hetohen në shtetin grek për kryerje të veprave penale “Krijimi i organizatës kriminale”, “Trafikimi i qënieve njerëzore me qëllim ushtrimin e prostitucionit” dhe “Pastrimi i parave”.

Duke i konsideruar shtetasit A. Sh. dhe S. Sh. si subjekte të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, (neni 3 pika 1 gërma “d”) organi i prokurorisë, bazuar në nenet 3 pika 2 gërma “a”; 6, 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 (më poshtë thjesht Ligji) ka kryer veprime hetimore në lidhje me zbulimin, identifikimin dhe verifikimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, aktiviteteve ekonomike të këtyre shtetasve dhe personave të lidhur me ta.

Në kuadër të hetimit pasuror ka rezultuar se, shtetasit nën hetim A. Sh. dhe S. Sh. si dhe personat e lidhur me to, prindërit A. e R. Sh. dhe kunati C. M., si subjekte të Ligjit në bazë të nenit 3 pika 2 gërma «a» dhe F. Z., si subjekt i Ligjit në bazë të nenit 3 pika 2 gërma “b” të tij, disponojnë pasuritë e mëposhtme:

Shtetasi A. Sh. është mbajtës i gjashtë llogarive bankare, të çelura në Bankën Intesa San Paolo, Dega Tiranë, në lekë, në dollarë amerikanë dhe në euro, të specifikuara si më poshtë:

Llogarisë bankare në leke, me Nr. xx xx xx xx xxx, të çelur në datë 11.08.2005 me gjendje faktike, në datën e verifikimit 21/05/2009, 2.966 lekë. Nga të dhënat e marra nga banka ka rezultuar se në këtë llogari bankare fillimisht është depozituar shuma prej 1.078.900 lekë (njëmilionë e shtatëdhjetëmijë e tetë) leke dhe më pas ajo është përdorur për tërheqje në shuma të vogla.

Llogarisë bankare në xxxxxx xxxxxxxxxx, me Nr. xx xx xx xx xx xx, të çelur në datë 17.05.2006, me depozitë fillestare 960 (nëntëqind e gjashtëdhjetë) dollarë dhe gjendje faktike në datën e verifikimit 21/05/2009, 967 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) dollarë. Në këtë llogari nuk kanë rezultuar të kryera veprime të tjera.

Llogarisë në xxxx, me Nr. xx xx xx xx xxx, të çelur në datë 14.01.2005, në shumën 200 (dyqindë) euro. Transaksioni i fundit në këtë llogari ka rezultuar i kryer në datë 03.01.2008, në shumën 13.000 (trembëdhjetëmijë) euro. Ky transaksion ka shërbyer për të çelur, në datë 03.01.2008, një llogari tjetër në euro. Gjendja e saj në datën e verifikimit, 21/05/2009, ka rezultuar zero.

Llogarisë në euro, me Nr. xx xx xx xx xx xx, të çelur në datë 08.11.2005, në shumën 2.000 (dymijë) euro. Në këtë depozitë kanë rezultuar të kryera veprime financiare, kryesisht depozitime në kesh, transferime të vlerave monetare në drejtim të Greqisë, kalime në llogari bankare me afat maturimi njëvjeçar. Gjendja e llogarisë në momentin e verifikimit, datë 21/05/2009, ka rezultuar 507.271 (pesëqindë e shtatëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) euro.

Llogarisë në euro, me Nr. xx xx xx xx xxx, të çelur në datë 03.01.2008, në shumën 13.111 (trembëdhjetëmijë e njëqind e njëmbëdhjetë) euro, shumë e cila është tërhequr nga njëra prej llogarive në euro të lartpërmendura. Në këtë depozitë janë kryer dy veprime financiare. Njëri prej tyre ka të bëjë me një depozitim në kesh të një shume prej 1(një) milion euro, kryer në datë 05.02.2009, me një afat maturimi 1 vjeçar. Për këtë transaksion, si burim për shumën 450.000 (katërqind e pesëdhjetëmijë) euro shtetasi A. Sh. ka deklaruar një hua të marrë nga kunati i tij, personi i tretë, C. M. duke paraqitur, në vërtetim të këtij pretendimi, Kontratën e Huasë, datë 06.02.2009 me afat shlyerje një vit.

Në datë 20.05.2009, mbi kërkesën e shtetasit A. Sh. është kryer veprimi i transferimit, nga llogaria e tij në drejtim të llogarisë së shtetasit C. M. , të shumës prej 500.000 euro me emërtimin “kthim borxhi”. Gjendja e kësaj llogarie në datë 21/05/2009, ka qënë në shumën 525.671 (pesëqindë e njëzet e pesemijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) euro dhe, në momentin e bllokimit 519,274.85 (pesëqindë e nëntëmbëdhjetëmijë e dyqindë e shtatëdhjetë e katër, pikë tetëdhjetë e pesë) euro.

Llogarisë në euro, me numur bazë të klientit XXXXXXXX dhe numer depozite me afat XXXXXXXXXXXXXXXX, të çelur pranë Bankës Intesa San Paolo, Dega



Fier, në datë 28/01/2003, në shumën rreth 500,000 (peseqindmijë) euro.  
Gjendja e

saj, në momentin e identifikimit, në datë 21/05/2009, ka qënë afërsisht 533,000 (pesëqind e tridhjetë e tremijë euro ndërsa, aktualisht është 549, 965.38 (pesëqind e dyzetë e nëntëmijë e nëntëqindë e gjashtëdhjetë e pesë, pikë tridhjetë e tetë) euro.

Shtetasi S. Sh. ka çelur, në datë xx.xx.xxxx, në Bankën Intesa San Paolo, Dega Tirane, një llogari bankare në euro, me Nr. xx xx xx xxx, në shumën prej 500.000 (pesëqindmijë) euro. Kjo shumë është vendosur në depozitë një vjeçare e cila, pas maturimit, në datë 09.01.2009 është vendosur sërish në depozitë një vjeçare me afat maturimi në datë 11.01.2010. Në momentin e çeljes së llogarisë, shtetasi S. Sh. ka deklaruar si burim të ardhurash aktivitetin e tij tregëtar. Kjo llogari bankare ka si mbajtës të parë shtetasin nën hetim S. Sh. dhe, si mbajtës të dytë personin e tretë F. Z. . Gjendja e kësaj llogarie në momentin e verifikimit ka qënë 522.561 (pesëqindë e njëzet e dymijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një) euro.

Shtetasi C. M. , ka rezultuar mbajtës i dy llogarive bankare në euro. Llogaria bankare me Nr. XX XX XX XX XXX, ka rezultuar e çelur në datë 20.05.2009, në Bankën Intesa San Paolo, Dega Tiranë, me një transaksion të vetëm, të kryer po në këtë datë, në shumën 500.000 euro, me burim të deklaruar, kthimin e borxhit nga shtetasi A. Sh. . Llogaria bankare në Bankën Alfa Bank, Dega Tiranë, me Nr. XX XX XX XX XX XXX, ka rezultuar e çelur në datë 30.04.2008. Në këtë llogari janë kryer disa transaksione, depozitime dhe, më pas transferime, në shuma prej 10.050 (dhjetëmijë e pesëdhjetë) euro, në drejtim të disa shtetaseve të huaja, femra, në qytetin Athinë, Greqi. Gjithashtu, në këtë llogari, në datë 31/03/2009 është transferuar, nga Av. Sh. D. , shuma prej 80.000 (tetëdhjetëmijë) euro, nën emërtimin “Kapar për blerjen e një toke dhe karburanti në autostradë, km.11”, ndodhur në fshatin Muçaj, Vorë, Tiranë. Toka dhe karburanti kanë rezultuar në pronësi të shtetasit A. Sh. . Gjendja e llogarisë në momentin e identifikimit ka qënë në shumën prej 80.028 (tetëdhjetëmijë e njëzet e tetë) euro.

Shtetasi F. Sh. Zeka ka patur pranë Bankës Alfa Bank, deri në datë 01/10/2007, llogarinë me Nr. XXXXXXXXXXXXX, numer i cili, me ndryshimin e sistemit të bankës, që nga data 02/03/2009 është XX XX XX XX XX XX XX XX. Në këtë llogari shtetasi F. Z. , në datë 22/09/2008 ka depozituar shumën prej 15.000 euro, të cilën e ka vendosur në depozitë me afat 3 mujor, ndërkohë që në datë 03.02.2009, ka depozituar shumën prej 100.000 (njëqindmijë) euro, të cilën, në po të njëjtën datë, e ka vendosur në depozitë me afat 1 vjeçar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi kërkesën e prokurorisë pranë saj, në kuadër të hetimit për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”,

me Vendimet Nr. 987 dhe 996 të datave respektive 26.05.2009 dhe 27.05.2009, ka vendosur sekuestron preventive mbi llogaritë e përshkruara më sipër.

Në kuadër të hetimit pasuror ka rezultuar gjithashtu se, shtetasit A. Sh dhe familjarët e tij, disponojnë pasuri të tjera të lujtëshme dhe të palujtëshme, të fituara para vitit 2006. Duke qënë të tilla, prokurori ka përjashtuar nga rrethi i pasurive që duhet t'i nënshtrohen masave parandaluese këto pasuri dhe llogaritë bankare me gjendje kapitali zero.

Në kuadër të hetimit pasuror, janë kryer verifikime të aktiviteteve ekonomike dhe tregëtare të shtetasve nën hetim A. e S. Sh. dhe, personave të tretë C. M. e F. Z. . Nga verifikimet e kryera ka rezultuar sa më poshtë:

Shtetasi A. Sh. ka rezultuar ortak dhe administrator i vetëm i Shoqërisë “SH.”, SH.P.K. Kjo shoqëri është rregjistruar në datë 09.02.2005, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Xxxxx dhe është subjekt tatimor i Degës së Tatimeve Tirane, me numur NIPTI x xxxxxxx x. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është tregëtia me pakicë dhe shumicë e karburanteve, bar-kafe, import dhe eksport mallrash të ndryshëm. **Nga të dhënat, kryesisht bilancet e dorëzuara, ka rezultuar se ky aktivitet është deklaruar me humbje.** Për të ushtruar këtë aktivitet ky shtetas ka blerë, në datë 31.12.2004 një sipërfaqe toke prej 4,100 (katërmijë e njëqind) m2, në fshatin Muçaj, Vorë, Tiranë dhe karburanti, që ndodhet aktualisht në të, ka Siglën e Shoqërisë “xxxxx xxx”.

Shtetasi S. Sh. ka rezultuar i rregjistruar, në datë 17.01.2007, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat si person fizik, për ushtrimin e aktivitetit ekonomik të tregëtimit me pakicë të karburanteve. Ky shtetas është rregjistruar edhe si subjekt tatimor në Zyrën e Tatim-Taksave, në Komunën Kurtalli, rrethi Berat, me numur NIPTI x xxxxxxxx x. **Ky aktivitet ka rezultuar i mbyllur në datë 19.02.2009.** Ushtrimi i këtij aktiviteti është kryer mbi një sipërfaqe toke, të rregjistruar në emër të shtetasit A. Sh. , babai i vëllezërve Sh. .

Shtetasi C. M. ka rezultuar i rregjistruar si subjekt tatimor i Degës së Tatimeve Xxxxx, në fushën e “Shërbimeve telefonike”, në datë 10.04.2008, me numur NIPTI x xxxxxxxxxxxx x. Nga të dhënat e marra në rrugë zyrtare, ka rezultuar se ky subjekt është vetëdeklaruar biznes i vogël. **Aktualisht është aktivitet i mbyllur.**

Shtetasi F. Z., sipas Shkresës Nr. 6119/1 Prot, datë 22.05.2009 të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit, së bashku me dokumentacionin përkatës, ka

rezultuar i rregjistruar në Degën e Tatimeve Berat, si subjekt tatimor me numur NIPTI x xxxxxxxxxxxx. Objekt i veprimtarisë së tij është ushtrimi i aktivitetit në fushën e serave, për mbjellje perimesh dhe dru-frutorësh.

Me rregjistrimin e procedimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, numrat telefonikë celularë, të identifikuar në përdorim të shtetasve C. M., F. Z. dhe A.Sh. janë vënë në përgjim me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

Nga përmbajtja e bisedave telefonike të përgjuara ka rezultuar se, personat e tretë C. M. dhe F.Z. kanë komunikime të vazhdueshme me shtetasin nën hetim A. Sh. që përdor vazhdimisht numer telefonik grek. Është e kuptueshme nga bisedat se personat nën hetim, vëllezërit Sh. , ndodhen në Greqi dhe janë shumë të interesuar për të krijuar alibi në funksion të veprave penale për të cilat janë duke u hetuar në Greqi .

Mbi këshillën e avokatit të tyre mbrojtës në Greqi A. , nëpërmjet komunikimit telefonik, i ka kërkuar ndihmë të afërmve dhe njerëzve të lidhur me të për kryerjen e veprimeve që të mund të justifikojë vlerat monetare të bllokuara në shtetin grek. Konkretisht, ai ka kërkuar përgatitjen e fotove të ndryshme të tokave në pronësi, të mbjella kryesisht me bostane, portokalle e tjera. Gjithashtu, ai ka kërkuar përpilimin e kontratave fiktive të qirasë, për marrje toke në përdorim, fotografimin e fshatarëve të ndryshëm që punojnë tokën me pagesë dhe të mjeteve bujqësore të marra me qira në mënyrë fiktive. Të gjitha dokumentat e përgatitura i ka kërkuar të noterizuara duke angazhuar në këtë drejtim shtetasit C. M., F. Z. dhe A. Sh.

Në kuadër të përgatitjes së dokumentave fiktive për të justifikuar pasuritë e sekuestruara nga autoriteti grek, A. i ka kërkuar të afërmve të tij që të kryejnë veprime të tilla në mënyrë që, karburanti i ndodhur në Vorë, me Siglën “xxxx xxx”, të figurojë në emrin e tij. Për këtë qëllim ai ka kërkuar përgatitjen e fotografive të montuara ku Sigla “xxxx xxx” të zëvendësohet me Siglën e Firmës “Sh.”, fotografimin e punëtorëve të ndryshëm, të veshur me bluza me mbishkrimin “Sh.”, duke punuar në këtë karburant.

Fakti i mësipërm ka rezultuar në bisedat e zhvilluara në datë 04.06.2009, midis A.nga numri telefonik 3069881000xx dhe disponuesit të numrit 068 38 37 226: “...+0xx tani dua fotografi të vendit aty, fotoqrafoje nga sipër, përballë ktej me grup 5-6 puntorësh me uniformë...dua të gjesh që shkruan “Sh.” ose bote që ti fotografosh me puntorë, dua një letër d.m.th një fletë që të shënohet që S. Sh. , A. Sh. , M. , I. M. , V. ku di unë T. ...punojnë dhe paguajnë sigurimet shoqërore te kjo firmë...”:

*“...+xxx merr T., merr C., merr ata puntorët që ke aty dhe bëj një fletë që punojnë...shiko nuk kontrollohen asgjëkundi këto...d.m.th një benzinatë që të shkruaj “Sh.”, mbasandaj do të çohesh sot do të vesh te F.... do të veni tek, atje ku janë mbjellë portokallet, do vini nja 5-6 vetë të shpërndarë që sikur punojnë, 5-6 vetë të shpërndarë nëpër arë sikur punojnë dhe A. me R., po të fotografuar mirë...të duken mos të bëjë bam që janë të njëjtit, dua pasaj të njëjtën gjë siç do bësh në Xxxxx me letër me puntorët, të njëjtën gjë bëje dhe atje që unë A. Sh. jam babai i S. dhe A. edhe mbikqyr punën e djemve të mi këtu...gjatë kohës që ata mungojnë duke drejtuar krahun puntor...”*

Qëllimi i shtetasit A. Sh., në kërkimin e tij për kryerjen e veprimeve të përshkruara më sipër, ka qënë që ai të mund të provojë se nga gjithë aktiviteti i tij privat arrin të sigurojë të ardhura në muaj rreth xx.xxx (xxxxxxxxxxx) xxxx.

Nga përmbajtja e bisedave të përgjuara ka rezultuar se një pjesë e dokumenteve të kërkuara nga shtetasi A. Sh. është përgatitur dhe i është dorëzuar në Greqi, nëpërmjet shoferëve të autobuzëve të linjës Shqipëri-Greqi.

Nisur nga fakti që shtetasit A. dhe S.Sh. si dhe, familjarët e tyre, kanë rezultuar me aktivitete tregëtare të rregjistruara, të deklaruara me humbje apo të mbyllura, duke qënë se pasuritë e disponuara prej tyre nuk justifikoheshin me nivelin e të ardhurave, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Xxxxx ka çmuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova, për kryerjen prej tyre të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Gjithashtu, duke çmuar se ndodhet para rasteve të parashikuara nga Ligji Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, materialin hetimor ia ka kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane.

Mbi kërkesën e Prokurorisë pranë saj, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, me Vendimin Nr. 09 datë 14.06.2010, bazuar në nenin 11 të Ligjit ka vendosur masën e sekuestros mbi pasuritë objekt konfiskimi. Ky vendim është lënë në fuqi me Vendimin Nr. 25 datë 07.02.2011 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tirane.

Në vendosjen e sekuestros (shih vendimin e mësipërm) gjykata ka arsyetuar qënien e shtetasve A. dhe S. Sh. si dhe, e personave të tretë C. M. dhe F. Z. , si subjekte të zbatimit të Ligjit, në referim të nenit 3 pika 1 gërma “d” dhe pika 2 gërma “a” dhe “b” të tij.

Në momentin e vendosjes së sekuestros për gjykatën, në kushtet kur shtetasit A. dhe S. Sh. kanë rezultuar persona nën hetim për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprave penale”, parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal, çelja e një numri të madh llogarish bankare në emër të tyre dhe në vlera të konsiderueshme, në periudhën pas vitit 2006, mungesa e aktiviteteve tregëtare të rregjistruara me bilance pozitive dhe fitime të mëdha, procedimi i tyre në shtetin grek për kryerje të veprave penale me rrezikshmëri të lartë dhe që sigurojnë të ardhura të mëdha, transferimi i shumave të parave në drejtim të Greqisë në emër të disa shtetaseve, përpjekjet e rezultuara në përmbajtjen e bisedave telefonike për të përgatitur dokumenta me qëllim krijimin e një alibije të një aktiviteti të gjerë dhe me të ardhura të mëdha në Shqipëri, për t’u përdorur para organeve të drejtësisë greke, kanë përbërë indicje të rëndësishme mbi bazën e të cilave janë ngritur dyshimet për kryerje, nga shtetasit A. Sh. dhe S. Sh. të veprës penale për të cilën janë duke u hetuar dhe që përfshihet në rrethin e veprave penale të përmendura në pikën 1 të Ligjit.

Shtetasit C. M. dhe F. Z. kanë rezultuar subjekte indirekte të zbatimit të Ligjit, për shkak të lidhjes së afërt me shtetasit nën hetim (C. M është kunati i tyre) apo ndikimit që kanë ushtruar në kryerjen e veprimtarisë së jashtëligjshme të tyre (F. Z. ka llogari të përbashkët me S. dhe është personi komunikues me A. për kryerjen e veprimeve fiktive).

Me paraqitjen në gjykatë të kërkesës me objekt konfiskimin e pasurive të përshkruara në pjesën hyrëse të vendimit prokurori, si përfaqësues i palës kërkuese, i qëndroi pretendimit të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në indicje, për pjesëmarrje të shtetasve nën hetim A. dhe S. Sh. në veprimtarinë kriminale për të cilën janë duke u hetuar.

Përfaqësuesi i posaçëm i shtetasve nën hetim dhe personave të tretë, para fillimit të hetimit gjyqësor të çështjes, referuar nenit 5 pika 3 të Ligjit paraqiti kërkesën me objekt pezullimin e gjykimit. Sipas tij, gjykata duhet të vendoste pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit në kushtet kur, mbi pasurinë objekt konfiskimi, në bazë të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, rëndonte masa e sekuestros preventive vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Xxxxx, me Vendimet Nr 987 dhe 996 datë 26.05.2009 dhe 27.05.2009. Gjithmonë sipas kërkesës, masa e pezullimit duhej të vendosej deri në dhënien e një vendimi gjyqësor për revokimin ose shuarjen e sekuestros preventive.

Gjykata, referuar të njëjtës dispozite ligjore, vendosi rrëzimin e kërkesës së

paraqitur duke e gjetur atë të pabazuar në ligj. Pika 3 e nenit 5 të Ligjit nuk bën fjalë për pezullimin e gjykimit të çështjes me objekt vendosjen e masave parandaluese por, për pezullimin e pasojave të zbatimit të tyre. Kjo do të thotë se, në rastet kur gjykata ka vendosur masa parandaluese mbi pasuri të cilat më parë i janë nënshtruar sekuestrimit apo konfiskimit sipas Kodit të Procedurës Penale, ajo është e detyruar të urdhërojë pezullimin e pasojave të zbatimit të tyre deri në një vendim gjyqësor që revokon ose shuan ato, gjithmonë në zbatim të atij Kodi.

Në kushtet kur çështja me objekt konfiskim pasurie ndodhej në proces gjykimi nuk mund të pretendohet të vendosej pezullimi i pasojave të zbatimit të një mase që nuk ishte vendosur ende. Përsa i përket pezullimit të pasojave të zbatimit të masës së sekuestrimit, për gjykatën ajo është një çështje që duhet të ishte marrë parasysh në momentin e disponimit me vendim në lidhje me këtë masë parandaluese.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 21 të Ligjit, sipas të cilit barra e provës i përket personit pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet, gjatë gjykimit, me pretendimin se pasuria objekt konfiskimi, në zotërim të shtetasve nën hetim A. dhe S. Sh. , është produkt i aktiviteteve të tyre të ligjshme të ushtruara në Greqi e Shqipëri, i marrëveshjeve të lidhura në fushën e biznesit dhe i të ardhurave të tjera të ligjshme, nga ana e përfaqësuesit të posaçëm të tyre u paraqitën provat e mëposhtme:

Dokumentat shkresore në lidhje me shoqërinë anonime “xxxxxxx i xxxxxx me xxxx”, me emërtimin specifik “xxxxxx S.A”, shoqëri turistike e themeluar në Athinë në Vitin 2007, sipas përfaqësuesit të posaçëm nga shtetasi A. Sh. dhe shtetasi grek P. A. . Në fakt, në përmbajtje të statutit figurojnë si aksionerë të vetëm shtetasit grekë P. A. dhe M. S. ndërsa përfaqësuesi i posaçëm e justifikon atë me çështje mirëbesimi. Nga përmbajtja e statutit, të paraqitur në gjykim, ka rezultuar se kapitali i kësaj shoqërie fillimisht ka qënë xxx.xxx xxxx. Më vonë kapitali është rritur në xxx.xxx e më pas në xxx.xxx xxxx dhe, për të provuar këtë pretendim u paraqitën gazeta zyrtare të qeverisë greke të viteve xxxx, xxxx dhe xxxxx ku pasqyrohet rregjistrimi i kësaj shoqërie dhe kjo rritje e pretenduar.

Për të provuar aktivitetin fitimprurës të kësaj shoqërie u paraqit edhe një kontratë shitblerje skafesh, datë 06.03.2007, lidhur midis Kompanisë “xxxxx xxx xx.x”, dhe kompanisë “xxxxxxxxx” për blerjen e një skafi, kundrejt çmimit xxx.xxx xxxx.

Pas zgjidhjes së konfliktit me shtetasin grek, sipas përfaqësuesit të posaçëm,

administrimi i plotë i shoqërisë ka kaluar tek A. Sh.. Për të vërtetuar këtë pretendim ai paraqiti dokumenta që i përkasin viteve xxxx, xxxx dhe xxxx dhe më konkretisht:

Sipas Procesvebalit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë të Anijeve të Përdorimit Argëtues me emërtimin “xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx x.x.x.x”, datë 11 Qershor 2009, ka rezultuar se shoqëria është vënë në proces xxxxxxx dhe, si përfaqësuese e A. Sh. është paraqitur motra e tij V. D.

Sipas marrëveshjes së krijimit të bashkëpronësisë datë 06.12.2010, shtetasi A. Sh., së bashku me shtetasin grek A. K. , kanë rënë dakort për administrimin e përbashkët të anijes veprimtari, e cila në bazë të vërtetimit të Drejtorisë Tatimore të Anijeve të Pireut, ka rezultuar se ka filluar në datë 05.01.2011.

Sipas vërtetimit, datë 10 Mars 2011, të Drejtorisë së Politikës Detare dhe Zhvillimit ka rezultuar se, Shoqëria “xxxxxxxxxxx xxxx x.x.x.x” është rregjistruar në datë 28.11.2008, është prishur vetgjyqësisht në datë 28.05.2009 duke u përfshirë në gjendje likuidimi dhe, duke pushuar në këtë mënyrë së qeni shoqëri. Anëtarë të këshillit drejtues kanë rezultuar A. Sh. dhe dy shtetas grekë.

Në kuadër të pretendimit për sigurimin e një pjesë të pasurisë objekt konfiskimi, në zotërim të shtetasit A. Sh. nga marrëdhënie biznesi, përfaqësuesi i tij i posaçëm paraqiti marrëveshjen e bashkëpunimit, datë 09.07.2007, midis shtetasve A. Sh. dhe S. G. (legalizuar në datë 09.07.2007 në Zyrën e Noteres M. Ç.me Nr. 5367 Rep Nr. 5367 Kol). Nga përmbajtja e saj ka rezultuar se objekti i marrëveshjes ka qënë krijimi i një shoqërie të përbashkët për transportin detar dhe turizmin me jahte në Republikën e Shqipërisë, me raport interesash 50 me 50 dhe kapital pese milionë euro.

Sipas marrëveshjes S. G. kishte detyrimin e dorëzimit tek A. të shumës prej dy milionë e pesëqind mijë euro në tre këste, kësti i parë prej nje milionë euro brenda datës 31 Dhjetor 2007, kësti i dytë prej nje milionë euro brenda datës 31 Dhjetor 2008 dhe, kësti i tretë po prej nje milionë euro brenda datës 31 Dhjetor 2009. Nga ana tjetër shtetasi nën hetim A. kishte detyrimin për sigurimin e ofertave për blerjen e jahteve.

Në funksion të marrëveshjes së mësipërme u paraqitën si provë edhe dy deklarata noteriale, me deklarues shtetasit A. Sh. dhe S. G., përpiluar respektivisht në datat 07.11.2007 dhe 31.12.2008 ku, deklaruesit



konfirmojnë faktin e dorëzimit dhe marrjes së shumave prej pesëqindëmijë e një milionë euro, jashtë zyrës së noterisë.

Për të provuar pretendimin e sigurimit të të ardhurave nga biznesi i ushtruar në Shqipëri u paraqitën me cilësinë e provës Vendimi Nr. 32838 datë 27.01.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane që bën fjalë për rregjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Xxxx” Sh.P.K, me ortak të vetëm shtetasin A. Sh.; Autorizimi i Bashkisë Vorë datë 01.05.2005, dhënë në favor të shtetasit A. Sh , për tregëtimin me pakicë të karburanteve, me afat x vjeçar si dhe, ekstrakte historike të rregjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” për subjektin “xxxx”, datë 1 dhe 2 Qershor 2010, në të cilat ka rezultuar se subjekti në fjalë nuk është në proces likuidimi.

U paraqitën gjithashtu dy kontrata qiraje, njëra e lidhur në datë 16.06.2006 me Nr. xxx Rep. Nr.xx Kol. sipas të cilës, shtetasi A. Sh. i ka dhënë me qira Shoqërisë “xxxx sh.p.k”, pikën e shitjes së karburantit të ndodhur në fshatin Muçaj xxxxx, për një afat pesë vjetësh, kundrejt shumën 50 000 lekë në muaj dhe tjetra, e lidhur në datë 25.05.2007, me Nr. xxx Rep. Nr. xxx Kol. po midis shtetasit A. Sh. dhe Shoqërisë “Vukaj Trans” sipas të cilës, është dhënë me qira një sipërfaqe prej x xxx mx, ndodhur në Muçaj Vorë për një periudhë prej tre vjetësh, kundrejt shumës 80 000 lekë në muaj. Duke ju referuar deklaratës së thjeshtë të presidentit të Shoqërisë “Vukaj Trans”, datë 04.06.2009, rezulton një mospërputhje me kontratën e qirasë. Në këtë deklaratë bëhet fjalë për marrjen me qira të sipërfaqes prj 2500 m2 dhe servise me sipërfaqe 600 m2, kundrejt një vlere qiraje 1700 Euro duke cilësuar si kohë të fillimit të marrëveshjes Marsin 2006.

Përsa i përket provave të sjella në funksion të pretendimit të sigurimit të të ardhurave nga aktiviteti bujqësor i familjes Shehu. ato do të trajtohen më poshtë, në momentin e shqyrtimit të pretendimeve dhe provave të paraqitura nga personi i tretë F. Z., në kushtet e parashtrimit të një aktiviteti të përbashkët në këtë fushë.

Personi i tretë C. M. , vetë dhe nëpërmjet përfaqësuesit të tij të posaçëm, pretendoi se, shuma prej 450 mijë euro, e depozituar fillimisht në llogarinë bankare Nr. xx xx xx xxx nga shtetasi A. Sh. si shumë e marrë borxh dhe, më pas e transferuar në llogarinë e tij, përfaqëson të ardhura nga aktiviteti personal dhe i familjes dhe, një pjesë e kësaj shumë është siguruar në formë boxhi të marrë tek shtetasit N.O. dhe A. H.

Sipas pohimit të personit të tretë C. M. në seancë gjyqësore, në Tropojë

kanë në zotërim si familje stabiliment sharrash, furrë buke që nga Viti 2006, pikë tregëtimi me shumicë të produkteve ushqimore dhe, ai vetë ka ushtruar aktivitet në fushën e shërbimeve telefonike.

Për të provuar pretendimin e mësipërm u paraqitën me cilësinë e provës Kontrata e Huasë Nr. xxx Rep. Nr. xxx Kol. datë 06.02.2009 (e paraqitur si e tillë edhe nga prokuroria) e lidhur midis palës huadhënëse C. M. dhe palës huamarrëse A. Sh. Nga përmbajtja e saj ka rezultuar se C. i ka dhënë A. huanë prej 450 000 (katërqind e pesëdhjetëmijë) euro me afat shlyerje një vit (datë kthimi 20.02.2010) dhe pa kamatë.

U paraqitën dokumenta të ushtrimit të biznesit në Tropojë në emër të vëllezërve të tij (e familjarëve) dhe konkretisht nipti i shtetasës N. M. , Bashkia Bajram Curri, rregjistruar në gjykatë në vitin 2006 dhe në organin tatimor në Vitin 2007, me objekt biznesi furrë buke; nipti i shtetasit E. M. për Vitin 2009 me të njëjtin lloj biznesi; nipti i shtetasit N. M. , Bashkia Bajram Curri, sipas të cilit ky shtetas është rregjistruar në gjykatë dhe në organin tatimor në Vitin 2006, me objekt biznesi tregëti me pakicë artikuj të ndryshëm dhe, transport malli vetëm për njësinë e vet. U paraqit plani i amortizimit dhe Deklarata Noteriale Nr. 2618 Rep. Nr. 354 Kol. datë 08.08.2008 sipas të cilave shtetasi S. M. ka marrë nga Fondi i Financimit të Zonave Malore një kredi në masën xxx mijë xxxx në Vitin 200, të cilën e ka shlyer në Vitin 2003.

Shtetasit N. M. e S. M. (vëllezër të C. M.) dhe N. O. e A. H. u paraqitën dhe dëshmuan para gjykatës, dy të parët për të ardhurat e siguruara nga familja dhe, për shumën e parave të dorëzuara vëllait të tyre C. M. ndërsa, dy të tjerët për shumën e parave të dhëna borxh C. M..

Sipas dëshmisë së shtetasit N. M. , ai së bashku me vëllezërit e tij, duke përfshirë edhe C. M. , pavarësisht se jetojnë në vende të ndryshme interesat pasurore i kanë të përbashkëta. Duke patur biznes në fushën e prerjes së drurëve (për të cilin disponon edhe makineri) dhe të tregëtimit të artikujve ushqimorë, të ardhurat e siguruara i ka investuar së bashku me vëllain e tij C.. Së bashku me vëllain tjetër Sadri, që jeton në Tropojë, kanë patur bagëti ndërsa S. edhe një furrë buke. Dy vëllezërit e ndodhur jashtë shtetit i kanë ndihmuar. Në kohën kur vëllai i tyre C. ka hyrë në marrëveshje për të blerë nga kunati i tij A. një sipërfaqe toke, të ndodhur në Vorë, në vitet 2008-2009, i kanë dhënë atij shumën prej 450 mijë euro, një pjesë e të cilët e kanë siguruar nëpërmjet borxheve të marra tek shtetasja N. O. dhe

A. H. , përkatësisht 30 mijë euro dhe 20 mijë euro.

Mbi pyetjen e prokurorit për shumën e të ardhurave të siguruara nuk është në gjendje të deklarojë shifra konkrete po kështu, nuk është në gjendje të thotë se me ç'farë shume ka kontribuar ai personalisht tek vëllai C. ndonëse, deklaroi se ja ka dhënë atë pjesë pjesë. Gjithashtu, nuk është në gjendje të tregojë shumën e përdorur për blerjen e karburantit të ndodhur në Vorë.

Dëshmitari S. M. ka deklaruar se, duke qënë pesë vëllezër, tre në Shqipëri dhe dy jashtë shtetit, janë marrë me aktivitete të ndryshme në blektori, lëndë drusore, furrë buke. Nga viti 1991 deri në 2008 ka patur një kope me bagëti me 200 kokë dele të cilat i ka shitur në Kosovë pasi, vëllait të tij C. i duheshin 450 mijë euro. Nga shitja e bagëtive ka përfituar shumën prej 240 mijë euro. Pranon se furra e bukës është biznes i familjes, administruar prej tij, djalit dhe bashkëshortes ndërsa sharra e vëllait të tij N. Të ardhurat e dërguara nga vëllezërit që jetojnë jashtë, sipas tij, i administrojnë bashkërisht.

Mbi pyetjen e prokurorit për të ardhurat konkrete të siguruara, ka deklaruar se xhiroja ditore e furrës së bukës, hapur në vitin 2004 (e licensuar), është 30 mijë lekë të vjetra. Nuk është në gjendje të thotë se ç'farë shume parash kanë marrë borxh, mbi kërkesën e C. , tek miq apo komshi. I pyetur përsëri për shumën e dhënë tek C. deklaroi katër mijë e pesëqind euro duke shfaqur një pasiguri të plotë në dëshminë e dhënë para gjykatës.

Dëshmitarja N. O. ka deklaruar se, në Dhjetor 2008 i ka dhënë C., nëpërmjet vëllait të tij N. M. (të cilin e ka komshi) një borxh në shumën 30 mijë euro, për një afat prej një viti. Aktualisht borxhi nuk është kthyer dhe ka besim në kthimin e tij për shkak të marrëdhënieve shumë të mira që ka me familjen M. . E pyetur lidhur me burimin e sigurimit të shumës së dhënë borxh ka deklaruar se ajo është rrjedhojë e kursimeve të familjes dhe e aktivitetit privat. Nga punësimi në shtet ajo vetë dhe bashkëshorti (me profesion inxhinier) sigurojnë shumën 1000 euro ndërsa, të ardhurat nga aktiviteti privat në klinikën private në Tiranë, të blerë pas Vitit 2010, llogariten 700 deri në 800 Euro. Krahas shumës së dhënë borxh ka disponuar edhe shumën prej 3 000 000 lekësh, të depozituar në Bankën Raiffeisen, të cilën e ka përdorur për blerjen e klinikës tek Zogu i Zi që ka kushtuar 4 300 000 lekë.

Dëshmitari A. H. ka deklaruar se, vëllai i C. , N. , i ka kërkuar në muajin Janar 2009 shumën prej 20 000 euro. Ka mësuar se kjo shumë i

nevojitej C. për tregëti dhe se do të kthehej pas një viti, pa interes. I pyetur për burimin e kësaj shume ka deklaruar se ajo është rrjedhojë e aktivitetit të tij në fushën e tregëtimit të mallrave ushqimore për të cilin është i licencuar prej pesë vjetësh. Nuk bën bilanc për të ardhurat por, në fund të vitit, sipas tij i ngelen 15 000 000 lekë (të vjetra). I pyetur për gjendjen aktuale të financave të tij ka deklaruar se nuk disponon para por, vetëm mall në vlerën 5 000 000 lekë (të vjetra).

Personi i tretë F. Z. , vetë dhe nëpërmjet përfaqësuesit të tij të posaçëm, pretendoi se pasuria që i përket atij, objekt konfikimi, ka si burim të saj të ardhurat e siguruara nga aktiviteti privat, i licencuar, në fushën e prodhimit të produkteve bujqësore, në sera të ndodhura në tokën në pronësi të tij dhe në toka të marra me qira dhe, borxhin në para të marrë tek vëllezërit e tij. Aktivitetin bujqësor e ka ushtruar në bashkëpunim me vëllezërit e tij dhe familjen Sh. duke i shitur produktet në persona juridikë dhe fizikë në një periudhë të gjatë kohore.

Sipas dëshmitarit Z. Z. (vëlla i personit të tretë F. Z.), në vitet 2008 apo 2009 vëllai i tij i ka kërkuar borxh shumë prej 100 000 euro për të filluar një aktivitet me jahtet dhe skafet. Duke i patur gjendje paratë e kërkuara borxh dhe të përfituara nga puna në sera, ia ka dhënë vëllait të tij. Ka mësuar se këto para vëllai i tij i ka mbyllur në bankë së bashku me shtetasin S. Sh. Nga prodhimi në sera, sipas tij, kanë mundur të sigurojnë rreth tetë milionë xxxx të vjetra në vit ndërkohë që, aktiviteti ka qënë i licencuar në vitet xxxx dhe 2009 dhe, më pas është mbyllur pasi nuk kanë patur interes. Mbi pyetjen e gjykatës për të justifikuar shumë e dhënë borxh tek vëllai i tij F. , ka deklaruar se nuk mund ta bëjë një gjë të tillë.

Me qëllim për të provuar aktivitetin bujqësor të pretenduar u paraqitën vërtetime të Kryetarit të Komunës Drenovicë, Berat, ku pasqyrohet fakti se familjet Sh. dhe Z. janë pronarë të disa hektarëve tokë të kthyer në sera si dhe, i shumë hektarëve të marra me qira, me përdorim të përvitshëm për prodhim perimesh të ndryshme. U paraqitën gjithashtu dokumenti i pronësisë i shtetasit F. Z. për sipërfaqen prej xxxx x arrë, të ndodhur në xxxxxx Ç.; nipti i shtetasit F. Z. për ushtrimin e aktivitetit serë djellore për kultivimin e perimeve, rregjistruar në gjykatë dhe organin tatimor në vitin 2008, së bashku me niptet përkatëse të vëllezërve të tij A. Z. dhe Z. Z.

Kryetari i i Komunës Kutalli Berat, shtetasi Sh. V. u paraqit me cilësinë e dëshmitarit duke deklaruar se familja Sh. dhe vëllezërit Z. kanë

në bashkëpunim midis tyre sipërfaqe të mëdha serash për kultivimin e perimeve. Për ndërtimin e serave ata kanë përdorur tokën në pronësi të tyre si dhe tokën e bashkëfshatarëve të marrë me qira. Të ardhurat e siguruar nga puna në bujqësi llogariten, sipas tij, në shumën 10 deri në 12 milion leke të vjetra për dynym. Aktiviteti bujqësor nuk është i licencuar dhe për të, fshatarët nuk paguajnë tatim. Gjëja e vetme që bën komuna në rastin e prodhimeve bujqësore është lëshimi i një vërtetimi që shoqëron mallin dhe që vërteton se ai është prodhim i fshatarit.

Për të provuar pretendimin e realizimit të përfitimeve të mëdha nga shitja e produkteve bujqësore u paraqitën me cilësinë e dëshmitarit shtetasit E. Z. dhe Xh. A.

Sipas dëshmitarit E. Z. , duke patur aktivitet në fushën e tregëtimit të fruta perimeve, me qendër në Fushë Krujë, biznes i madh, që nga Viti 2000 ka patur marrëdhënie biznesi me shtetasin F. Z. , tek i cili është furnizuar vazhdimisht me perime. Për njëmbëdhjetë muaj, sipas tij, xhiroja shkon deri në gjashtëdhjetëmilionë xxxx dhe, në funksion të biznesit ka marrëdhënie edhe më fshatarë të tjerë. Bilance ka vetëm për produktet që merr nga jashtë ndërsa për ato të vendit nuk ka. Për tërheqjen e mallit nga fshati Drenovicë i nevojitej vetëm një vërtetim i kryetarit të komunës.

Sipas dëshmitarit Xh. A., zotërues i një biznesi të vogël për tregëtimin e fruta perimeve me qendër në Tregun e ish Uzinës Dinamo, tek shtetasi F. Z. është furnizuar me perime. Krahas F. ai është furnizuar edhe në fshatarë të tjerë duke shkuar atje ku malli ishte më cilësor. Nuk disponon dokumenta për të provuar mallin e blerë tek Fatosi.

**Ndodhur përpara pretendimeve të mësipërme të shtetasve nën hetim dhe personave të tretë për shuma të marra në formë huaje apo borxhi si dhe, para dëshmive të shtetasve që pranonin një fakt të tillë, gjykata mbi kërkesën e prokurorit, bazuar në nenet 189 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe, nenit 22 pika 3 të Ligjit thirri me cilësinë e personit të tretë shtetasit N. M. , S. M., Z. Z. , N. O. , A. H. dhe S. G. të cilët, u përfaqësuan në gjykim nga përfaqësuesi i tyre i posaçëm. Av. Sh.D.**

Përfaqësuesi i posaçëm i personave të tretë të thirrur në gjykim N. M. , S. M. , Z. Z., N. O. dhe A. H. , në emër të

tyre deklaroi se nuk dispononte asnjë provë për të provuar prejardhjen e shumave në para që ata kishin kaluar në favor të shtetasve nën hetim apo personave të tretë C. M. dhe F. Z. , në formë borxhi, duke mbetur në kuadrin e deklarimeve të dhëna prej tyre me cilësinë e dëshmitarit.

Për personin e tretë S. G. , përfaqësuesi i tij i posaçëm, duke ju referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur midis S. dhe A. , në Vitin 2007, për të ndërtuar një shoqëri të përbashkët lundrimi jahtesh, me provat e paraqitura pretendoi të provojë se shumata prej një milionë e pesëqind mijë euro e dorëzuar me këtë rast, në dy këste, është produkt i veprimtarisë së ushtruar nga personi i tretë në biznese të ndryshme. Personi i tretë S. G. , sipas tij, ka ushtruar aktivitete biznesi në Shqipëri duke privatizuar Fabrikën e Çimentos në Vlorë dhe duke u bërë aksioner me shtetin në Fabrikën e Cimentos në Fushë Krujë, në raportin xx me xx. Pavarësisht se aktualisht Fabrika është shitur, për dhjete vjet ajo ka qënë në aktivitet duke i siguruar atij të ardhura të mëdha. Gjithashtu S. G. ka qënë aksioner në Fabrikën e Vajit në Sarandë dhe në Insitutin e Ndërtimit në Tiranë.

Në kuadër të provueshmërisë së pretendimeve të mësipërme u paraqit si provë Kontrata, datë 18.09.1993, e lidhur midis Personit Juridik Fabrikës së Çimentos Fushë Krujë dhe Personit Juridik Firmës së Huaj X.X xxxxxxxx-xxx xxxxxxxx XxxX, xxxxxx-xxx xxxxxxxxxxxxxxx, me përfaqësues S. G. Nga përmbajtja e saj ka rezultuar se palët kanë rënë dakort për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike të përbashkët, për një periudhë kohe prej 25 vjetësh. Krahas kontratës u paraqitën edhe të gjitha aktet që kanë shoqëruar krijimin e kësaj shoqërie e cila, sikurse rezulton nga Vendimi Nr. 7475 datë 20.10.1993 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, është rregjistruar pranë saj me emrin “xxx” (xxxx xxxxxxxx xxxxxx). Në Raportin e Ekspertit Kontabël “Për kontributet e ortakëve në Kapitalin e Shoqërisë “xxx” ka rezultuar se, kapitali i derdhur nga ortaku i huaj ka qënë xxx xxx xxx, e llogaritur në masën xx.xx % ndërsa, kapitali i ortakut shqiptar xxx xxx xxx e llogaritur në xx xx %.

U paraqitën gjithashtu llogaritë vjetore, gjendja financiare e shoqërisë për periudhën 01 Janar 1995 deri në 31 Dhjetor 1995 si dhe raporti vjetor ekonomik-financiar i Vitit 1996.

Për të provuar burimin e financimit të personit të tretë S. G. në blerjen e

fabrikave të çimentos, u paraqitën me cilësinë e provës marrëveshje financimi,

datë 13 Tetor 1995 dhe 17 Janar 1996, midis xxxx xxxxxxxxxx xxxxxx me qëndër në Breshia Itali dhe xx xxxxxx-xxx xxxxxx xxxxxx sipas të cilës, A. ka marrë përsipër të xxxxxx xx për për blerjen e fabrikave të Çimentos në Fushë Krujë dhe Vlorë.

Për të provuar aktivitetin privat të ushtruar nga personi i tretë S. G. në Shqipëri si dhe, shumat që ai ka dorëzuar tek A. , në kuadër të marrëveshjes së biznesit (të trajtuar më sipër), u paraqit dëshmitari A. H. , shtetas kosovar. Sipas dëshmitarit, S. G. ka qënë aksioner në Fabrikën e Vajit në Sasaj Sarandë, ka privatizuar Fabrikën e Çimentos në Vlorë dhe Fushë Krujë, Insitutin e Ndërtimit në Tiranë dhe ka zotëruar jahtet e para në Shqipëri, të sjella në vitet 1994, 1995. Personalisht ka asistuar në një bisedë të zhvilluar midis S. dhe A. në Korrik apo Gusht 2007 për ndërtimin e një shoqërie të përbashkët jahtesh në Shqipëri. Ka qënë dëshmitar në dorëzimin e kështit të parë prej 500 mijë euro dhe, të kështit të dytë prej një milionë euro. Mbi pyetjen e prokurorit për aktivitetin e Syles ka deklaruar se Fabrika e Vajit në Sasa të Sarandës është shkatërruar në Vitin 1997, me trazirat që ndodhën në atë vit ndërsa, për Fabrikën e Çimentos në Fushë-Krujë di që S. është në proces gjyqësor pasi, shteti ia ka shitur dikujt tjetër.

**Gjykata, në analizë të provave të paraqitura dhe marra në gjykim, konkludon se kërkesa e Prokurorisë për konfiskimin e llogarive bankare, sipas përshkrimeve në pjesën hyrëse të vendimit, është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.**

Në pikën 1 të nenit 24 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” parashikohet shprehimisht:

*“Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:*

- a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicje, për pjesmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;*
- b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe*
- c) kur rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë të personit”.*



Në interpretim dhe zbatim të kësaj dispozite Gjykata çmon se, për vendosjen e masës parandaluese të konfiskimit, është e domosdoshme vërtetimi i ekzistencës njëkohësisht të tre kushteve që kanë të bëjnë: **1.** Me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, bazuar në indicje për pjesmarrje në veprimtari kriminale të parashikuar në nenin 3 të Ligjit, që bën fjalë për fushën e zbatimit të tij; **2.** Me prejardhjen e paligjshme të pasurisë apo mosjustifikimin e zotërimit të saj, referuar nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të tjera të ligjshme të deklaruara dhe **3.** Me zotërimin e plotë apo të pjesshëm të pasurisë nga personi i proceduar drejtpërdrejt apo tërthorazi.

Në çështjen në gjykim, mbi bazën e provave të paraqitura, të marra dhe të shqyrtuara në kushtet e debatit gjyqësor, gjykata konkludon për ekzistencën njëkohësisht të tre kushteve të sipërpërmendura për vendosjen e masës së konfiskimit.

**Së pari: Ndaj shtetasve nën hetim A. Sh. dhe S. Sh. ekziston dyshimi i arsyeshëm, në nivelin e indicjeve, për pjesmarrje në veprimtarinë kriminale në fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale, e parashikuar si fushë e zbatimit të Ligjit në nenin 3 pika 1 gërma “d” të tij.**

Qenia e shtetasve A. dhe S. Sh. në pozitën e personave nën hetim për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprave penale”, parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal, çelja e një numri të madh llogarish bankare në emër të tyre dhe në vlera të konsiderueshme, në periudhën pas vitit 2006, mungesa e aktiviteteve tregëtare të rregjistruara me bilance pozitive dhe fitime të mëdha, procedimi i tyre në shtetin grek për kryerje të veprave penale me rrezikshmëri të lartë dhe që sigurojnë të ardhura të mëdha, transferimi i shumave të parave në drejtim të Greqisë në emër të disa shtetaseve, përpjekjet e rezultuara në përmbajtjen e bisedave telefonike për të përgatitur dokumenta me qëllim krijimin e një alibije të një aktiviteti të gjerë dhe me të ardhura të mëdha në Shqipëri, për t’a përdorur para organeve të drejtësisë greke, për gjykatën përbëjnë indicje të rëndësishme mbi bazën e të cilave ngrihet dyshimi për kryerje, nga shtetasit A. Sh. dhe S. Sh. të veprës penale për të cilën janë duke u hetuar dhe që përfshihet në rrethin e veprave penale të përmendura në pikën 1 të Ligjit.

Shtetasit C. M dhe F. Z për shkak të lidhjeve të afërta me shtetasit nën hetim A. dhe S. Sh konsiderohen subjekte indirekte të zbatimit të Ligjit, në referim të nenit 3 pika 2 gërma “a” dhe “b” të tij. Të tillë u përfshinë në gjykim edhe shtetasit Z. Z , N. O A. H S. M , N. M dhe S. G të cilët, me cilësinë e personit

të tretë, patën detyrimin për të provuar prejardhjen e ligjshme të pronës apo, për të justifikuar zotërimin e saj, referuar nivelit të të ardhurave.

**Së dyti: Me provat e paraqitura dhe të marra në gjykim, shtetasit nën hetim dhe personat e tretë nuk arritën të provonin prejardhjen e ligjshme të pasurive objekt konfiskimi apo, të justifikonin zotërimin e shumave të pretenduara si të dhëna borxh apo hua.**

Në zbatim të pikës 3 të nenit 21 të Ligjit, nga përfaqësuesi i posaçëm i shtetasve nën hetim A. dhe S. Sh. u paraqitën dokumenta shkresore që dëshmonin për shoqëri të krijuara në fushën e lundrimit në Greqi por ato, pavarësisht kërkesës së përsëritur të gjykatës, nuk u shoqëruan me bilance, të dhëna konkrete për të ardhurat dhe fitimet e realizuara nga ushtrimi i veprimtarisë së tyre. Për më tepër, një pjesë e mirë e dokumentave të paraqitura i përkisnin periudhës pas rregjistrimit të procedimit pasuror dhe, si të tilla nuk mund të vlerësoheshin nga gjykata me cilësinë e provës.

U pretendua se shuma prej një milionë e pesëqind mijë euro, e depozituar nga shtetasi A. Sh në llogari bankare, kishte si burim të saj shumën e marrë nga personi i tretë S. G , në funksion të marrëveshjes së bashkëpunimit realizuar midis tyre. Për gjykatën një pretendim i tillë mbeti i paprovuar në kushtet kur, përfaqësuesi i posaçëm nuk solli prova konkrete për të provuar burimin e sigurimit të kësaj shume parash nga vetë personi i tretë S. G . Provat e paraqitura për llogari të personit të tretë S. G si ato shkresore dhe me dëshmitarë nuk dhanë njoftime për të ardhurat konkrete të realizuara prej tij. Edhe aty ku flitej për bilance apo të ardhura bëhej fjalë për shumë vite para periudhës së realizimit të marrëveshjes së tij me shtetasin nën hetim A. Sh . Nga ana e përfaqësuesit të posaçëm nuk u arrit të paraqitej qoftë edhe një dokument i vetëm që të vërtetonte sesi është lëvruar kjo shumë e madhe parash ndërkohë që, rezultoi se bizneset e shtetasit S. G në Shqipëri nuk janë aktive. Rezultoi në gjykim se Fabrika e Çimentos në Fushë Krujë i është shitur dikujt tjetër dhe përfaqësuesi i posaçëm, ndonëse pretendoi se ajo ka prodhuar të ardhura për llogari të klientit të tij për dhjetë vjet me rradhë, nuk solli dokumenta për të provuar një pretendim të tillë. Rezultoi se Fabrika e Vajit në Sasaj Sarandë është shkatërruar që në Vitin 1997 ndërsa, për Insitutin e Ndërtimit në Tiranë nuk u paraqit asnjë dokument për të provuar qoftë edhe objektin e veprimtarisë së tij.

Ndonëse u pretendua për shuma të mëdha të ardhurash të realizuara nga shfrytëzimi i sipërfaqeve të mëdha të tokës, të kthyer në sera djellore, provat e paraqitura në funksion të këtij pretendimi nuk e bindën gjykatën për bazueshmërinë e tij. Fotografitë e paraqitura me pamje të serave dhe dëshmitarët e thirrur për këtë qëllim çmohen nga gjykata si prova të pamjaftueshme për të

provuar sigurimin e fitimeve në shuma të mëdha, në mungesë të dokumentave shkresore dhe zyrtare.

Pretendimi se një pjesë e pasurisë objekt konfiskimi përfaqëson huanë e marrë nga A. tek personi i tretë C. M., në shumën 450 mijë Euro, për gjykatën mbeti i paprovuar.

Vetë personi i tretë C. M nuk arriti të provojë që shuma prej 450 000 euro është produkt i të ardhurave të siguruara nga aktiviteti i tij në fushën e shërbimeve telefonike, nga aktiviteti i familjes dhe marrëdhëniet e huasë. Dokumentat e paraqitura provuan faktin se, të afërm të tij në Bajram Curri janë regjistruar në organin tatimor për të ushtruar biznes si persona fizikë dhe, aktiviteti i tyre edhe sikur të pranojmë që i përket familjes së madhe Murataj, nuk mund kurrsesi të justifikojë shumën e madhe të pretenduar. I pavërtetë mbetet deklarimi me cilësinë e dëshmitarit i shtetasit S. M për sigurimin e shumës prej 240 000 euro nga shitja e bagëtive. Në këtë konkluzion gjykata arrin si në vlerësim të përmbajtjes së dëshmisë ashtu edhe të pasigurisë së shfaqur dukshëm nga dëshmitari në seancë gjyqësore.

Pretendimi i personit të tretë C. M për marrjen e një sasive parash në formë borxhi nga shtetasit N. O dhe A. H mbeti i paprovuar përderisa këta të fundit, të thirrur me cilësinë e personi të tretë, nuk paraqitën asnjë provë për të provuar disponimin faktit të tyre. Dëshmia e dhënë prej tyre në seancë gjyqësore për gjykatën është e pamjaftueshme në mungesë të provave shkresore për të ardhurat konkrete që ata kanë mundur të sigurojnë në periudhën para “dhënies së borxhit”.

Pretendimi i personit të tretë F. Z se një pjesë e shumës së parave të depozituara në bankë, në emër të tij dhe shtetasit nën hetim S. Sh , përfaqëson fitimin e siguruar nga ushtrimi i aktivitetit në fushën e tregëtimit të produkteve bujqësore dhe një pjesë përfaqëson borxhin e marrë tek vëllai i tij Z. Z , për gjykatën mbeti i paprovuar.

Ndonëse u pretendua për një aktivitet shumë të gjerë dhe fitimprurës në fushën e kultivimit dhe tregëtimit të perimeve në sera djellore, me një shtrirje kohorë disa vjeçare, provueshmëria e tij u kufizua thjesht në paraqitjen e disa dëshmitarëve që pohuan ekzistencën e marrëveshjes me shtetasin F. Z për blerjen e produkteve bujqësore. Si personi i tretë F. Z dhe dëshmitarët e paraqitur me kërkesën e tij nuk ishin në gjendje të vërtetonin me dokumenta realizimin konkret të marrëveshjes së pretenduar.

Dëshmitari Z. Z , i thirrur më pas me cilësinë e personit të tretë deklaroi para gjykatës se nuk mund të provonte disponimin prej tij të shumës prej një

qindmijë euro, të pretenduar si e dhënë borxh tek vëllai i tij F. Z. .

**Së treti: Pasuria objekt konfiskimi ka rezultuar nën zotërimin e drejtpërdrejtë të shtetasve nën hetim A. Sh e S. Sh , si subjekte direkte të zbatimit të Ligjit dhe, personave të tretë C. M dhe F. Z , si subjekte indirekte të tij.** Ky fakt ka rezultuar si nga dokumentat bankare, të administruara me cilësinë e provës, ashtu edhe nga procesvervbalet “Për kryerjen e veprimeve përmbartimore gjatë ekzekutimit”, datë 01. dhe 02. Shkurt 2011 të Zyrës së Përmbartimit Tiranë.

Në bazë të pikës 3 të nenit 25 të Ligjit, sipas të cilit në vendimin përfundimtar caktohet detyrimi për pagimin e shpenzimeve të parapaguara nga shteti gjykata, referuar raportit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, dërguar me Shkresën Nr. 209/4 Prot datë 18.02.2011, mbi bazën e disponimit të mësipërm, çmon se ky detyrim duhet ti ngarkohet solidarisht shtetasve nën hetim dhe personave të tretë.

Në kushtet kur administratori i caktuar nga gjykata gjatë fazës së sekuestrimit të pasurive nuk e ushtron me këtë funksion, bazuar në nenin 31 të Ligjit kjo detyrë duhet ti caktohet administratorit zëvendësues.

## **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në nenet 24 pika 1, 25, 26 e 28 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, 299 e 310 të Kodit të Procedurës Civile.

## **V E N D O S I**

- Pranimin e kërkesës, konfiskimin e pasurive e mëposhtme:
- **1.** Llogarisë bankare në xxxx, në Bankën xxxxx xxx xxxx, Dega xxxxx, me Nr. xx xx xx xx xxx, e hapur në datë xx.xx.xxxx, në emër te A. Sh me gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xx/xx/xxxx) x.xxx (xxxxx x xxxxxxxx x xxxxxxxxxxxx x xxxxxx ) xxxxx.
- **2.** Llogarisë bankare në xxxxx xxxxxxxxxxx, në Bankën xxxxxx xxxxx xxxx, Dega xxxxx, me Nr. xx xx xx xx xx xx, e hapur në datë xx.xx.xxxx, në emër të A. Sh, me depozitim fillestar xxx (xxxxxxxxx x xxxxxxxxxxx) xxxxxx xxxxxxxxxxx dhe gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xx/xx/xxxx) xxx (xxxxxx e xxxxxxxxxxx e xxxxxx) xxxxxx amerikanë.
- **3.** Llogarisë bankare në xxxx, në Bankën xxxxx xxx xxxxx, Dega Xxxx

me Nr.xx xx xx xx xx xx, e hapur në datë xx.xx.xxxx, në emër të A. Sh , me gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xx/xx/xxxx) xxx.xxx (xxxxx x xxxxxxxx x xxxxx x xxxxxxxxxx x xxx) xxxx.

- **4.** Llogarisë në xxxx, në Bankën xxxx xxx xxxx, Dega xxxxx, me Nr. xx xx xx xx xxx, e hapur në datë xx.xx.xxxx, në emër të A. Sh , me gjendje në momentin e verifikimit (datë xx.xx.xxxx), xxx.xxx (xxxxx x xxxxx x xxxxxxxx x xxxxxxxx x xxx) xxxx dhe, gjendje aktuale xxx.xxx.xx (xxxxxx x xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx x xxxxx x xxxxxxxxxxxx x x, xxxx xxxxxxxxxxxx x xxxxx) xxxx.
- **5.** Llogarisë bankare në xxxx, në Bankën xxxxx xxx xxxxx, Dega xxxx, në emër të A. Sh , me numur bazë të klientit xx xx xx dhe numur depozite me afat xxxx xx xx xx xx xx xxx, me gjendje në momentin e verifikimit (datë xx.xx.xxxx), xxx,xxx (xxxxxx x xxxxxxxx x xxxxx) xxxx dhe gjendje aktuale xxx.xxx.xx (xxxxxx x xxxxx e xxxxxxxx e xxxxxxxx e xxxxxxxxxxxx e xxxxx, pike xxxxxxxx e xxxxx) xxxx.
- **6.** Llogarisë bankare në xxx, në Bankën xxxx xxx xxxxx, Dega Xxxxx, me Nr. xx xx xx xx xxx, e hapur në datë xx.xx.xxxx, në emër të S. Sh dhe F. Z , në shumën prej 500.000 (pesëqindmijë) euro, me gjëndje aktuale në momentin e verifikimit (datë xx.xx.xxxx), xxx,xxx (xxxxxx x xxxxxxxx x xxxxxxxx x xxxxxxxx x xxx) xxxx.
- **7.** Llogarisë bankare në xxxx, në Banken Intesa San Paolo, Dega, Tirane, me Nr. xx xx xx xx xxx, e hapur në datë xx.xx.xxxx, në emër të C. M , me një transaksion të vetëm, po në këtë datë, në shumën 500.000 (pesëqindmijë) euro.
- Për administrimin e përdorimin e pasurive të konfiskuara dhe, ekzekutimin e vendimit ngarkohen Zyrat e Përmbarimit Gjyqësor në Tirane dhe Fier dhe administrator A. H. , në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.
- Shpenzimet procedurale të kryera në shumën 952.776 (nëntëqind e pesëdhjetë e dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë si dhe, shpenzimet gjyqësore u ngarkohen personave nën hetim A. Sh dhe S.Sh si dhe, personave të tretë C. M , F. Z , S. G , N. M , S. M , N. O A. H dhe Z. Z .
- Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit brenda pesëmbëdhjetë ditëve, nga e nesërmja e shpalljes, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda

Tiranë.

**SEKRETARE**

**ANDINA KAJA**

**GJYQTARE**

**LILJANA BAKU**



